REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

Nr. Rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	05.01.2026	Aktet (draft apo të miratuara) mbi lehtësitë fiskale për gazetari investigative.	15.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se Administrata Tatimore është një organ ligjzbatues dhe jo politikbërës. Lutemi për trajtimin e kërkesës suaj t'i drejtoheni institucioneve kompetente.	E plotë	Nuk ka
2	19.01.2026	Sa call center operojnë aktualisht të regjistruar në Shqipëri? Sa punonjës janë të regjistruar aktualisht? Sa kontrolle janë kryer gjatë 3 viteve të fundit?	30.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Administrata Tatimore nuk disponon statistika sipas formatit të kërkuar. Lidhur me të dhënat e kërkuara, sqarojmë se, objekti i veprimtarisë së subjekteve të regjistruara pranë QKB jo gjithmonë është i kufizuar në një aktivitet të vetëm. Në rastet kur një subjekt, në momentin e regjistrimit, ku ka deklaruar një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike, pa evidentuar një aktivitet të veçantë apo kryesor, nuk është e mundur të identifikohet në mënyrë të veçantë aktiviteti kryesor i subjektit, përsa kohë nuk ka një deklarim nga tatimpaguesi se kush është aktiviteti kryesor që ai kryen.	E plotë	Nuk ka

3	30.01.2026	Informacion nëse ka ndonjë ligj apo udhëzim i cili fal gjobat apo kamatvonesat të cilat janë për shkak të plotësimit me vonesë të DIVA-s.	05.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, Administrata Tatimore ju informon se institucionet kompetente do të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, 'Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore, si dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë'. Në këto akte do të parashikohet edhe procedura përkatëse për zbatimin e këtij ligji, e cila, në vijim do t'ju bëhet me dije të gjithë tatimpaguesve.	E plotë	Nuk ka
4	05.02.2026	Sa është numri i tatimpaguesve të regjistruar në fushën e mediave audiovizive, sa gazetarë janë të punësuar?	19.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Tatimpagues të pajisur me nipt të cilët ushtrojnë aktivitet në fushën e Mediave audiovizive, të shkruar dhe elektronike janë 1,219 subjekte. Gjatë vitit 2025 gazetar të punësuar në total janë 1,201. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se: Kjo kategori tatimpaguesish gazetarë/punonjës të medias regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Kodi NACE-2 bëhet me vetëdeklarim nga ana e tyre. Të dhënat e regjistrimit, konkretisht Klasa 4 shifrore, transmetohen nga QKB dhe Administrata Tatimore është përfitues i të dhënave. Administrata Tatimore më pas, administron të dhënat e dërguara për tatimpaguesit, me ndarje të llojit të	E plotë	Nuk ka

				veprimtarive ekonomike sipas klasave të parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2. Lutemi gjeni bashkëlidhur Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2, (e cila është e publikuar edhe në faqen zyrtare të INSTAT), përmes së cilës mund të përcaktohet lloji i aktivitetit dhe kodi NVE Rev 2, për të cilën jeni i interesuar, në mënyrë të tillë që t'ju vendosim në dispozicion një informacion më të plotë.		
5	16.02.2026	Sa individë janë të regjistruar si influencer? Sa para janë gjeneruar nga individë nëpërmjet platformave digjitale?	10.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se, Administrata Tatimore nuk disponon statistika sipas formatit të kërkuar**,** për arsye se: Kategoria e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet si "influencer" regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku kodi NACE Rev.2 deklarohet me vetëdeklarim nga ana e subjektit. Sqarojmë se objekti i veprimtarisë së subjekteve të regjistruara pranë QKB-së nuk është domosdoshmërisht i kufizuar në një aktivitet të vetëm, pasi në momentin e regjistrimit subjektet mund të deklarojnë një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike. Të dhënat e regjistrimit (Klasa 4-shifrore sipas NACE Rev.2) transmetohen nga QKB tek Administrata Tatimore, e cila është përfituese e këtyre të dhënave dhe i administron ato sipas klasifikimit të	E plotë	Nuk ka

				përcaktuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2). Megjithatë, nuk ekziston një klasifikim i veçantë specifik për aktivitetin “influencer”, ndaj gjenerimi i statistikave të sakta në këtë rast është i pamundur. Sa i përket të ardhurave të gjeneruara nga platformat digjitale, Administrata Tatimore është duke punuar për regjistrimin e këtyre platformave në Shqipëri, me qëllim evidentimin dhe monitorimin e të ardhurave që realizohen përmes tyre. Informacion shtesë mund të merret edhe pranë institucioneve bankare, sipas kërkesës, pasi edhe Administrata Tatimore, në raste të caktuara dhe në kuadër të planeve të saj, kërkon të dhëna pranë bankave.		
6	17.02.2026	Si plotësohet deklarata e DIVA 2025? A ka ndonjë video ilustruese?	18.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Për mënyrën e plotësimit të kësaj deklarate ka të publikuar video në faqen zyrtare të tatimeve si dhe në rrjetet sociale, ku jepen udhëzime dhe instruksione hap pas hapi mbi mënyrën e plotësimit të deklaratës DVAP. Video udhëzuesin mund ta ndiqni këtu: https://youtu.be/xmUqnbudbEk?si=eFE4mqRxiDILhOp3	E plotë	Nuk ka

<table>
<tr>
<td>7</td>
<td>20.02.2026</td>
<td>Numri total i subjekteve ekonomike që zhvillojnë aktivitet në hoteleri ‘akomodim’ dhe shpërndarja sipas qyteteve dhe numri total i të punësuarëve</td>
<td>04.03.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Administrata Tatimore përpunoi informacionin duke identifikuar tatimpaguesit aktivë që kanë përshkrim aktiviteti “akomodim”,

<table>
<tr><th>DRT</th><th>Nr i NIPT-ve</th><th>Nr mesatar punonjesish 2025</th></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat</td><td>94</td><td>281</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër</td><td>64</td><td>181</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM</td><td>18</td><td>2,325</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës</td><td>394</td><td>2,704</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan</td><td>85</td><td>318</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier</td><td>54</td><td>216</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër</td><td>127</td><td>347</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë</td><td>175</td><td>769</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës</td><td>39</td><td>100</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë</td><td>142</td><td>552</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë</td><td>665</td><td>1,772</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër</td><td>303</td><td>1,112</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë</td><td>615</td><td>3,468</td></tr>
<tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë</td><td>437</td><td>1,663</td></tr>
<tr><td>Total</td><td>3,212</td><td>15,808</td></tr>
</table>
</td>
<td>E plotë</td>
<td>Nuk ka</td>
</tr>
<tr>
<td>8</td>
<td>25.02.2026</td>
<td>A ka deleguar firmën drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ilir Binaj tek nëpunësit në mungesë të tij në datat 19.02.2026-25.02.2026</td>
<td>10.03.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon:
Bazuar në parashikimet konkrete të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" (nenet 11 e vijues), "Kodit të Procedurave Administrative" (neni 34), dhe tërësisë së akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e administratës publike, në të gjitha rastet e mungesës, të pamundësisë apo të paaftësisë afatshkurtër për të vepruar, kryerja e detyrave të titullarit apo çdo drejtuesi të Administratës Tatimore është bërë nga personi zëvendësues i caktuar sipas ligjit.
Në këtë kuptim, Administrata Tatimore konfirmon ekzistencën e urdhrit për delegimin e kompetencave, të lëshuar nga nëpunësi z.Ilir Binaj, për periudhën</td>
<td>E plotë</td>
<td>Nuk ka</td>
</tr>
</table>

				19.02.2026 deri më 25.02.2026, për arsye familjare dhe shëndetësore.		
9	27.02.2026	Sa subjekte me aktivitet fasoneria janë të regjistruara në QKB, sa është numri i të punësuarëve, sa janë me status aktiv dhe pasiv?	06.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, Administrata Tatimore ju bën me dije se: Në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2 nuk ka një përcaktim të tillë, tatimpagues të regjistruar me emërtimin 'fasoneri'. Sqarojmë se Administrata Tatimore administron të dhëna lidhur me këta tatimpagues vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Kodeve Ekonomike NVE Rev 2 dhe jo sipas përcaktimit të cituar nga kërkuesi. Në përmbushje të misionit dhe detyrimeve të saj për transparencë, Administrata Tatimore publikon informacion përmes raporteve vjetore, të cilat janë të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit.	E plotë	Nuk ka
10	18.03.2026	Sa kontrolle tatimore janë kryer në sektorin e basteve dhe lojërave të fatit për 2 vitet e fundit?	25.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Administrata Tatimore nuk disponon statistika të gjeneruara sipas formatit të kërkuar nga ana juaj. Në përmbushje të misionit dhe detyrimeve të saj për transparencë, Administrata Tatimore publikon informacion përmes raporteve vjetore, të cilat janë të	E plotë	Nuk ka

				disponueshme dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit (https://www.tatime.gov.al/)		
11	18.03.2026	Kërkojmë një vërtetim për pagim detyrimesh të organizatës jofitimprurëse "X"	26.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se shërbimi "Vërtetim për pagim detyrimesh" ofrohet online në portalin e-Albania. Mund t'a aksesoni përmes linkut të mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11169	E plotë	Nuk ka
12	08.04.2026	Informacion nëse marrëveshja "Për shmangien e taksimit të dyfishtë'' nënshkruar me Sllovakinë, ka hyrë në fuqi apo jo? Nëse po, në çfarë datë?	08.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutemi në linkun bashkëlidhur gjeni informacionin e kërkuar https://www.tatime.gov.al/c/6/125/marreveshje-nderkombetare	E plotë	Nuk ka
13	14.04.2026	Informacion lidhur me detyrimin për pajisje me POS për pranimin e pagesave pa para në dorë (non-cash).	22.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar pikës 3, të nenit 59/3, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, e shtuar me ligjin nr. 79/2025, është parashikuar shprehimisht: 3. Terminali "POS/POI" është pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave bankare apo të instrumenteve të tjera të pagesave elektronike në pikën e shitjes ose të ndërveprimit. Informacioni për pagesën	E plotë	Nuk ka

				merret nëpërmjet faturave letër nga terminalet mekanike ose elektronike. Gjithashtu, referuar edhe relacionit që ka shoqëruar ndryshimin ligjor, ky ndryshim ligjor vjen në kuadër të politikave për reduktimin e përdorimit të parasë në dorë, nxitjen e pagesave elektronike dhe garantimin e shërbimit për vizitorët e huaj që preferojnë të paguajnë me karta bankare debiti/krediti. Pra, qëllimi i dispozitës dhe i ligjit është nxitja e tatimpaguesve të pajisen me terminale të certifikuara që lehtësojnë kryerjen e transaksioneve elektronike duke rritur transparencën dhe ulur varësinë nga pagesat me para në dorë. Për këtë qëllim, përdorimi i aplikacioneve telefonike për pranimin e pagesave nga ana e subjekteve tatimpagues është një mekanizëm ligjor dhe i pranuar, por përdorimi i aplikacioneve telefonike nuk përjashton tatimpaguesin nga detyrimi ligjor që të disponojë në ambiente të ushtrimit të aktivitetit edhe terminale për pranimin e pagesave me kartë bankare debiti/krediti.		
14	28.04.2026	Informacion nëse subjekti 'X' është i regjistruar në organet tatimore, është i pajisur me nipt, sa punonjës ka të deklaruar?	11.05.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Bizneset në Republikën e Shqipërisë regjistrohen fillimisht pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), i cili është institucioni përgjegjës për kryerjen e regjistrimit fillestar të subjekteve tregtare	E plotë	Nuk ka

				dhe pajisjen e tyre me Numrin e Identifikimit për Personin e Tatueshëm (NIPT). Pas përfundimit të regjistrimit, të dhënat përkatëse të subjektit transmetohen në mënyrë automatike dhe elektronike tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), për qëllime të regjistrimit fiskal dhe administrimit të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi. Sa më sipër, në faqen zyrtare të QKB publikohet informacioni bazë për të gjithë subjektet e regjistruara dhe të pajisura me NIPT, i cili është i aksesueshëm për të gjithë në adresën zyrtare www.qkb.gov.al. Çdo informacion që nuk është i publikuar në QKB, konsiderohet konfidencial dhe si i tillë trajtohet nga Administrata Tatimore, në përputhje me nenet 24, 25 dhe 31 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.		
15	29.04.2026	Sa është numri total i personave të punësuar si gazetar dhe punonjës të mediave nga viti 2016 deri në vitin 2026 në Republikën e Shqipërisë.	14.05.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Kategoria e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku kodi NACE Rev.2 deklarohet me vetëdeklarim nga ana e subjektit. Sqarojmë se objekti i veprimtarisë së subjekteve të regjistruara pranë QKB-së nuk është	E plotë	Nuk ka

				domosdoshmërisht i kufizuar në një aktivitet të vetëm, pasi në momentin e regjistrimit subjektet mund të deklarojnë një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike. Sa më sipër, në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2 nuk ka një përcaktim të tillë, tatimpagues të regjistruar si punonjës të medias. Sqarojmë se Administrata Tatimore administron të dhëna lidhur me këta tatimpagues vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Kodeve Ekonomike NVE Rev.2 dhe jo sipas përcaktimit të cituar nga kërkuesi. Përsa i përket numrit të të punësuarëve në fushën mediatike, e cila përfshin kategori të ndryshme si televizioni, media e shkruar, radio etj, gjeni informacionin si më poshtë: **Vitet** / **Nr. i të punësuarëve** 2016 — 4,492 2017 — 4,643 2018 — 4,693 2019 — 4,738 2020 — 5,053		

				<table><tr><td>2021</td><td>5,128</td></tr><tr><td>2022</td><td>5,242</td></tr><tr><td>2023</td><td>4,956</td></tr><tr><td>2024</td><td>4,741</td></tr><tr><td>2025</td><td>4,472</td></tr><tr><td>Total</td><td>48,158</td></tr></table> Lutemi gjeni bashkëlidhur Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2, (e cila është e publikuar edhe në faqen zyrtare të INSTAT), përmes së cilës mund të përcaktohet lloji i aktivitetit dhe kodi NVE Rev 2, për të cilën jeni të interesuar, në mënyrë të tillë që t'ju vendosim në dispozicion një informacion më të plotë. Lutemi mbani parasysh se të dhënat e mësipërme janë përpunuar bazuar në klasifikimin e veprimtarive ekonomike sipas NVE Rev.2 dhe mund të mos pasqyrojnë në mënyrë plotësisht të saktë numrin real të punonjësve të medias apo të marrëdhënieve me publikun, për shkak se subjektet e deklarojnë vetë objektin e aktivitetit, për rrjedhojë mund të ushtrojnë më shumë se një veprimtari ekonomike.		

16	06.05.2026	Informacion mbi hapat që duhet të ndjekë me qëllim për të përfituar nga rimbursimi 10% i TVSH, pas shitjes së produktit industrial duhan në janar 2026	12.05.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutemi gjeni informacion në linkun bashkëlidhur https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1916/pyetje-dhe-pergjigje-kompensimi-i-fermereve-permes-autofatures	E plotë	Nuk ka
17	02.06.2026	Informacion zyrtar dhe i përditësuar në fuqi për vitin 2026, lidhur me fushat e mëposhtme: Tatimi mbi pagën/të ardhurat nga punësimi, Person fizik, i vetëpunësuar, profesion i lire, Tatimi mbi fitimin, biznesin, shpk, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatimi në burim, Afatet tatimore dhe penalitetet (formularë zyrtarë të llogaritjes së tatimit mbi pagën mujore, shembuj zyrtarë, normën standarte të tvsh-së, mënyrën e llogaritjes së detyrimeve tatimore për person fizik etj)	15.06.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se i gjithë kuadri ligjor që rregullon funksionimin e Administratës Tatimore dhe që është i detyrueshëm për zbatim nga tatimpaguesit, është lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare të Administratës Tatimore www.tatime.gov.al në seksionin “Legjislacioni”, “OJF dhe Ente Publike”, si dhe në rubrikat përkatëse të informimit të tatimpaguesve. Për rrjedhojë, çdo subjekt mund të njihet me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përmes këtij burimi zyrtar informacioni.	E plotë	Nuk ka
18	04.06.2026	Sa është numri total i personave të vetëpunësuar gjatë periudhës janar - dhjetor 2025? Sa është numri total i të rinjve (15-29 vjeç) të vetëpunësuar gjatë periudhës janar-dhjetor 2025?	17.06.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Numri total i personave të vetëpunësuar për vitin 2025 është 95070 persona nga të cilët 32547 janë femra dhe 62523 janë meshkuj.	E plotë	Nuk ka

<table>
<tr><td></td><td></td><td>Sa është numri i të rinjve (15-17 vjeç) të punësuar në vitin 2025?</td><td></td><td>Numri total i personave të vetëpunësuar për vitin 2025 për grupmoshën 15-29 vjeç është 8950 persona nga të cilët 2701 janë femra dhe 6249 janë meshkuj.

Numri total i personave të punësuar për vitin 2025 për grupmoshën 15-17 vjeç është 297 persona nga të cilët 92 janë femra dhe 205 janë meshkuj.</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>19</td><td>15.06.2026</td><td>Numri i subjekteve të vogla tregtare aktiv sipa bashkive</td><td>24.06.2026</td><td>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, neni 3, pikat 2 dhe 3, tatimpaguesit e regjistruar në sistemin tatimor klasifikohen në dy kategori: "Person Fizik" dhe "Entitet".

<table>
<tr><th>Drejtoria Rajonale Tatimore</th><th>Entitet</th><th>Person fizik</th></tr>
<tr><td>DRT Berat</td><td>674</td><td>16,617</td></tr>
<tr><td>DRT Dibër</td><td>595</td><td>5,648</td></tr>
<tr><td>DTM</td><td>1,268</td><td>39</td></tr>
<tr><td>DRT Durrës</td><td>5,007</td><td>18,945</td></tr>
<tr><td>DRT Elbasan</td><td>1,331</td><td>21,342</td></tr>
<tr><td>DRT Fier</td><td>1,824</td><td>39,418</td></tr>
</table>
</td><td>E plotë</td><td>Nuk ka</td></tr>
</table>

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>DRT Gjirokastër</td><td>577</td><td>6,778</td></tr>
<tr><td>DRT Korçë</td><td>1,067</td><td>24,798</td></tr>
<tr><td>DRT Kukës</td><td>469</td><td>3,240</td></tr>
<tr><td>DRT Lezhë</td><td>1,068</td><td>6,363</td></tr>
<tr><td>DRT Sarandë</td><td>738</td><td>6,270</td></tr>
<tr><td>DRT Shkodër</td><td>1,531</td><td>14,393</td></tr>
<tr><td>DRT Tiranë</td><td>20,212</td><td>48,678</td></tr>
<tr><td>DRT Vlorë</td><td>1,963</td><td>11,557</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>38,324</td><td>224,086</td></tr>
</table>
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>20</td>
<td>15.06.2026</td>
<td>Jam një individ që në deklaratën e vitit 2025, me ka dal nga tatimet: Kredia tatimore: X lekë. Dua të di a rimbursohen këto para? Nëse rimbursohen ca duhet të bej? Duhet të bëj ndonjë kërkesë?</td>
<td>15.06.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si vijon:
Për vlerën e tatimit të mbipaguar, ju keni të drejtën e paraqitjes së kërkësës për rimbursim sipas hapave të mëposhtëm:

* Logohuni në llogarinë personale në e-filing, në menunë “E-filing im”, klikoni “profili im”, dhe më pas “detajet e bankës”
* Kliko në Shto llogari bankare. Plotësoni fushat e kërkuara duke përzgjedhur bankën dhe të dhënat e sakta të IBAN.
* Më pas në menunë “çështjet e mia”, do të paraqisni kërkësën për rimbursim duke</td>
<td>E plotë</td>
<td>Nuk ka</td>
</tr>
</table>

				klikuar “krijo çështje”, zgjidh “pyetje të përgjithshme” dhe shtyp “krijo”. * Pas shfaqjes së mesazhit “çështja e re u krijua me sukses” vijoni me plotësimin e kërkesës dhe në kutinë“lloji i komunikimit” zgjidhni “shkresë njoftuese”. * Ngarkoni dokumentin e lëshuar nga banka për numrin e llogarisë bankare. * Ngarkoni çertifikatën familjare, kur kërkoni zbritjet nga fëmijët apo arsimimin e tyre, si dhe kontratën me institucionin/tatimpaguesin, faturat tatimore tëfiskalizuara, për shpenzimet e fëmijëve për zbritjet e bëra. * Pasi të keni ngarkuar dokumentat e nevojshëm, dorëzoni kërkesën duke shtypur butonin “dorëzo”. Kërkesa do të trajtohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku jeni të regjistruar e cila do të vijojë me hapat për rimbursimin në llogarinë tuaj. Shënim! Me kërkesë dhe dëshirë të individit shuma e mbipaguar apo teprica kreditore mbartet për vitin e ardhshëm. Video udhëzues për mënyrën e aplikimit për rimbursim: https://youtu.be/bnJJ3wHYa10?si=gooktpbzj_aA2xzG		

21	26.06.2026	A mund të shiten produktet e fermës me NIPT fermeri nëpërmjet një pike shitje ambulante ose të lëvizshme? Në cilat raste kërkohet regjistrimi i një subjekti tregtar shtesë, në momentin që unë mund të marr produkte nga fermerët e tjerë apo që në momentin që shes produktet dhe nënproduktet e mia të fermës time?	09.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar kuadrit ligjor rregullues në fuqi, regjistrohen si ”fermerë” pranë Drejtorive Rajonale Tatimore prodhuesit bujqësorë, të cilët përmbushin gjithashtu edhe detyrimet e përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë”, përsa ky regjistrim është i detyrueshëm për fermerët që zbatojnë skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë. Që prodhuesit bujqësorë të jenë subjekte të kompesimit dhe të plotësojnë kushtet për t’u regjistruar si ‘’fermer” referuar nenit 147, të ligjit nr. 92/2014, “Për TVSH-në” i ndryshuar, duhet që: a)qarkullimi vjetor i tyre nuk tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave; b)furnizojnë mallra apo shërbime me prejardhje nga puna e tyre e kryer në njërën nga aktivitetet e përcaktuara, sipas shkronjës “d”, të nenit 145, të këtij ligji; c)mallrat dhe shërbimet u furnizohen personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit në Republikën e Shqipërisë; ç)janë pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga	E plotë	Nuk ka

				Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor, pa iu nënshtruar detyrimit për deklarim, sipas nenit 106, të këtij ligji. Fermerët nuk kanë detyrim ligjor të lëshojnë fatura, pasi faturat në emër të tyre lëshohen nga grumbulluesi/blerësi i produkteve bujqësore. Çdo fermer që i nënshtrohet këtij regjimi, në mënyrë të vullnetshme mund të zgjedhë t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, duke iu nënshtruar çdo të drejte dhe detyrimi për regjistrim, deklarim, llogaritje dhe pagesë të TVSH-së sipas përcaktimeve ligjore dhe duke hequr dorë kështu nga statusi i "fermerit". Fermeri, i cili i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së, dorëzon në Drejtorinë Rajonale Tatimore certifikatën e NIPT-it me të cilën është pajisur për të përfituar nga skema e kompensimit si fermer, duke u çregjistruar nga kjo skemë kompensimi dhe regjistrohet si subjekt për tregtim të produkteve bujqësore pranë QKB. Gjithashtu, çdo fermer që furnizon (shet) produktet e tij bujqësore sipas këtij regjimi, qarkullimi vjetor i të cilit është mbi kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, është i detyruar t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së duke iu nënshtruar çdo të drejte dhe detyrimi për regjistrim, deklarim, llogaritje dhe pagesë të TVSH-së sipas përcaktimeve më sipër.		

22	30.06.2026	Jam një subjekt tregtar dhe jam i interesuar për të caktuar një përfaqësues tatimor rezident. Doja të dija procedurën dhe dokumentet që duhen paraqitur për regjistrimin e përfaqësuesit tatimor.	01.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Rregullat dhe procedurat e detajuara për emërimin/caktimin, regjistrimin, funksionimin dhe përgjegjësinë e përfaqësuesit tatimor nga personat jorezidentë janë parashikuar në pikën 9, të udhëzimit 24, dt.02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të cilin e gjeni të publikuar në faqen zyrtare (web) të Administratës Tatimore.	E plotë	Nuk ka
23	06.07.2026	Në çfarë forme regjistrohen zakonisht motorristët që punojnë përmes platformave digjitale? A regjistrohen si: punëmarrës; persona fizikë të vetëpunësuar; të punësuar nga një subjekt nënkontraktor; ose në një formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni fiskal? Cilat janë detyrimet tatimore të motorristëve që ushtrojnë aktivitet nëpërmjet platformave digjitale dhe cili është subjekti përgjegjës për deklarimin dhe pagesën e tyre?	17.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar legjislacionit tatimor në fuqi, Administrata Tatimore nuk përcakton dhe nuk klasifikon marrëdhëniet juridike të punës ndërmjet palëve kontraktuese, pasi përcaktimi i natyrës së marrëdhënies së punës dhe statusit të personit që ushtron aktivitet përbën çështje që vlerësohet në bazë të legjislacionit të punës, legjislacionit civil dhe dokumentacionit kontraktor konkret ndërmjet palëve. Për pasojë, personat që ofrojnë shërbime nëpërmjet platformave digjitale mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre në forma të ndryshme juridike dhe fiskale, në varësi të mënyrës së organizimit të marrëdhënies ekonomike. Këto forma mund të	E plotë	Nuk ka

		Në rastet kur platforma operon përmes nënkontraktorëve, cili subjekt konsiderohet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve fiskale që lidhen me motorristët?		përfshijnë marrëdhënie punësimi, veprimtari ekonomike si person fizik, angazhim përmes një subjekti të tretë punëdhënës ose forma të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Vlerësimi i secilit rast bëhet mbi bazën e rrethanave konkrete faktike dhe dokumentacionit përkatës. Në rastet kur personi ushtron aktivitet ekonomik në mënyrë të pavarur, për llogari të vet dhe në emrin e vet, ai konsiderohet subjekt i detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 29/2023, datë 30.03.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar si dhe nga legjislacioni tatimor dhe procedural në fuqi. Në këto raste, personi mban përgjegjësi për regjistrimin, deklarimin dhe përmbushjen e detyrimeve tatimore sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Ndërsa, në rastet kur ekziston marrëdhënie punësimi në kuptim të legjislacionit përkatës, detyrimet për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, i takojnë punëdhënësit, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993,		

				"Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", të ndryshuar. Lidhur me rastet kur platforma digjitale operon nëpërmjet nënkontraktorëve ose subjekteve të ndërmjetme, përgjegjësia fiskale vlerësohet sipas rolit dhe statusit juridik të secilit subjekt në marrëdhënien konkrete. Nëse motorristët ose korrierët janë të punësuar nga një subjekt i tretë, ky subjekt konsiderohet punëdhënës dhe mban përgjegjësi për përmbushjen e detyrimeve fiskale dhe deklarative që lidhen me punëmarrësit e tij, sipas legjislacionit në fuqi.		
24	07.07.2026	Informacion lidhur me procedurën përpara se të fillojmë proçedurën për të kërkuar NIPT-in në Shqipëri nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor, i cili regjistrohet për këtë funksion në drejtorinë rajonale tatimore në bazë të një prokure të lëshuar nga ne, dmth personi jorezident, mund të na informoni ju lutem nëse personi që duhet të zgjedhim për këtë funksion, mund të jetë çdo qytetar shqiptar, i pajisur me	28.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Në zbatim të nenit 86, pika 1, dhe nenit 87 të Ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", TVSH-ja paguhet nga personi i tatueshëm që kryen furnizimin e tatueshëm, ndërsa, kur personi përgjegjës për pagesën e TVSH-së është jorezident, ai është i detyruar të caktojë përfaqësues tatimor në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur marrësi i furnizimit është person i tatueshëm, i regjistruar për TVSH në Republikën e Shqipërisë.	E plotë	Nuk ka

		NIPT që jeton në Republikën e Shqipërisë, apo duhet të ketë ndonjë kriter me specifik që duhet të përmbushi?		Gjithashtu, neni 9 i Ligjit nr. 9920/2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, parashikon detyrimin e tatimpaguesit jorezident për emërimin e një përfaqësuesi tatimor rezident, kur kjo kërkohet nga legjislacioni tatimor shqiptar. Rregullat dhe procedurat për emërimin, regjistrimin, funksionimin dhe përgjegjësinë e përfaqësuesit tatimor përcaktohen në pikën 9 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i publikuar në faqen zyrtare të administratës tatimore.		
25	16.07.2026	Sa është vlera e të ardhurave të mbledhura nga taksa e qarkullimit për 10 vitet e fundit?	29.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Administrata Tatimore nuk disponon statistika të gjeneruara sipas formatit të kërkuar nga ana juaj. Në përmbushje të misionit dhe detyrimeve të saj për transparencë, Administrata Tatimore publikon informacion përmes raporteve vjetore, të cilat janë të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit (https://www.tatime.gov.al/).	E plotë	Nuk ka

26	28.09.2026	1. A mund të regjistrohem si tregtar ambulant si jorezident nga Kosova? 2. A vlen regjistrimi në gjithë Shqipërinë? 3. A mjafton vetëm leja për zënien e hapësirës publike? 4. A mund ta mbaj biznesin aktiv në Kosovë njëkohësisht?	12.10.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë: -Po. Shtetasit e huaj mund të regjistrohen si person fizik në Shqipëri. Regjistrimi bëhet te QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit). Mund të përdoret edhe përfaqësues me prokurë. Dokumentat e huaja kërkojnë përkthim dhe legalizim. Për statusin ambulant, duhet të regjistroheni edhe në Administratën Tatimore dhe të plotësoni kushtet specifike të ambulantit. -Çdo bashki mund të ketë rregullat, tarifat dhe zonat e veta ku lejohet shitja ambulante. -Në praktikë, po. Ju duhet leje nga bashkia ku do të ushtroni aktivitetin. Ligji e parashikon shprehimisht këtë kusht. Shënim praktik: Nëse lëvizni nga Tirana në Durrës, Vlorë, Shkodër etj., duhet të verifikoni kërkesat dhe tarifat e secilës bashki veç e veç. -Po. Nuk ka ndalim të përgjithshëm për të pasur biznes në Kosovë dhe aktivitet të regjistruar në Shqipëri në të njëjtën kohë. Kini parasysh:	E plotë	Nuk ka

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td></td>
<td>Do të keni detyrime tatimore në Shqipëri për aktivitetin e ushtruar këtu.
Nëse aktiviteti bëhet i konsiderueshëm, mund të lindin çështje të rezidencës tatimore dhe të tatimit mbi të ardhurat.
Kur aplikohet, vlen marrëveshja për shmangien e tatimit të dyfishtë Shqipëri–Kosovë.
Për një aktivitet ambulant të vogël, çështja kryesore është regjistrimi korrekt dhe deklarimi i të ardhurave sipas legjislacionit shqiptar.</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
<tr>
<td>27</td>
<td>21.09.2026</td>
<td>Informacion mbi shumën totale vjetore e arkëtuar nga Renta Minerare për nxjerrjen e naftës bruto për vitin 2024 dhe vitin 2025;
- Të dhënat zyrtare mbi shumat e transferuara efektivisht nga Thesari i Shtetit drejt buxheteve të Bashkive për vitin 2024 dhe vitin 2025;</td>
<td>05.10.2026</td>
<td>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë:
- Totali i rentës minerare të paguar për vitet 2024 dhe 2025, të ndara sipas Drejtorive Rajonale:

<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Emërtimi</th><th>Viti 2024</th><th>Viti 2025</th></tr>
<tr><td>1</td><td>DRT Berat</td><td>30,903</td><td>36,606</td></tr>
<tr><td>2</td><td>DRT Dibra</td><td>113,532</td><td>87,207</td></tr>
<tr><td>3</td><td>DRT Durrësi</td><td>134,254</td><td>79,082</td></tr>
<tr><td>4</td><td>DRT Elbasani</td><td>36,882</td><td>35,585</td></tr>
<tr><td>5</td><td>DRT Fieri</td><td>4,418</td><td>29,916</td></tr>
<tr><td>6</td><td>DRT Gjirokastra</td><td>4,650</td><td>5,529</td></tr>
<tr><td>7</td><td>DRT Korca</td><td>15,716</td><td>12,527</td></tr>
<tr><td>8</td><td>DRT Kukësi</td><td>8,640</td><td>5,730</td></tr>
<tr><td>9</td><td>DRT Lezha</td><td>31,198</td><td>21,961</td></tr>
<tr><td>10</td><td>DRT Saranda</td><td>7,040</td><td>7,222</td></tr>
<tr><td>11</td><td>DRT Shkodra</td><td>21,850</td><td>18,776</td></tr>
<tr><td>12</td><td>DRT Tirana</td><td>88,940</td><td>75,970</td></tr>
<tr><td>13</td><td>DRT DTM</td><td>582,863</td><td>553,517</td></tr>
<tr><td>14</td><td>DRT Vlora</td><td>27,415</td><td>21,860</td></tr>
</table>

-Të dhënat mbi shumën e transfertave të kryera për secilën njësi të vetëqeverisjes</td>
<td>E plotë</td>
<td>Nuk ka</td>
</tr>
</table>

				vendore nuk janë të dhëna që gjenerohen apo përllogariten nga Administrata Tatimore.		
28	02.10.2026	Informacion lidhur me kërkesën për regjistrimin si Person Fizik për ushtrimin e një aktiviteti të vetëpunësuar (freelance), -Cilat janë detyrimet tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore? -Sa do të jetë përafërsisht shuma mujore që duhet të paguani për të ardhura prej 50,000 lekësh në muaj? -A ka detyrime të tjera tatimore ose deklarime periodike? -Cila është baza mbi të cilën llogariten kontributet?	06.10.2026	-Cilat janë detyrimet tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore? Pas regjistrimit në QKB si person fizik, do të regjistroheni automatikisht edhe pranë administratës tatimore. Si i vetëpunësuar, detyrimet kryesore janë: • Pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore; • Pagesa e kontributeve të sigurimeve shëndetësore; • Deklarimi i të ardhurave të realizuara nga aktiviteti; • Pagesa e tatimit mbi të ardhurat sipas legjislacionit tatimor në fuqi, nëse krijohet detyrim tatimor. -Sa do të jetë përafërsisht shuma mujore që duhet të paguani për të ardhura prej 50,000 lekësh në muaj? Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar nuk llogariten mbi të ardhurat reale mujore të aktivitetit, por mbi pagën minimale/maksimale kontributive të përcaktuar me aktet ligjore në fuqi.	E plotë	Nuk ka

				Për këtë arsye, edhe nëse të ardhurat tuaja janë rreth 50,000 lekë në muaj, kontributet do të llogariten mbi bazën kontributive të përcaktuar nga legjislacioni dhe jo domosdoshmërisht mbi shumën e të ardhurave të realizuara. -A ka detyrime të tjera tatimore ose deklarime periodike? Po. Në varësi të natyrës së aktivitetit dhe nivelit të të ardhurave, mund të keni detyrimin për: • Deklarimin periodik të kontributeve; • Dorëzimin e deklaratës vjetore të të ardhurave personale; • Lëshimin e faturave për shërbimet e ofruara sipas legjislacionit të fiskalizimit; • Mbajtjen e dokumentacionit dhe evidencave të aktivitetit. Cila është baza mbi të cilën llogariten kontributet? Për personat e vetëpunësuar, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore llogariten mbi bazën minimale ose maksimale kontributive të përcaktuar me vendimet përkatëse në fuqi dhe jo mbi të ardhurat reale mujore të deklaruara nga aktiviteti.		

29	03.10.2026	Informacion për subjektin X, lidhur me deklarimet tatimore, kamatvonesat, gjobat, kontrollet tatimore, faturat përkatëse.	07.10.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, Administrata Tatimore bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në nenin 24 të tij ka përcaktuar shprehimisht autoritetet të cilave AT ka detyrimin e vënies në dispozicion të informacionit tatimor lidhur me tatimpaguesin, si dhe rastet e dhënies së këtij informacioni. Në nenin 25 “Konfidencialiteti”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet se: “Nëpunësit dhe punonjësit e Administratës Tatimore, qendrore, dhe vendore, ruajnë konfidencialitetin e të dhënave tatimore dhe financiare të tatimpaguesit, që i kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrës.” Të dhënat e kërkuara nga ana juaj përbëjnë të dhëna tatimore bazuar në nenin 31, “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave”, pika 2 e ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet se: “E dhënë tatimore dhe financiare është çdo informacion, i cili merret nga Administrata Tatimore, gjatë ushtrimit të funksioneve, tek tatimpaguesi ose palët e treta”. Referuar sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve konstaton se janë kërkuar të dhëna tatimore, për të cilat Administrata Tatimore ka detyrimin ligjor të ruajtjes së konfidencialitetit të tyre	E Refuzuar	Nuk ka

30	06.10.2026	Informacion mbi kodin e profesionit për punonjësit e sektorit të pastrimit.	14.10.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Vendosja e kodit të profesionit për një punonjës, vendoset nga Punëdhënësi, gjatë marrjes në punë kur plotësohet formulari Sig 27, nga faqja e-filing, bazuar në VKM Nr. 514, datë 20.9.2017 PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR, të cilën e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Administratës Tatimore në link-un bashkëlidhur https://www.tatime.gov.al/c/2021/6/73/kontributet-e-sigurimeve-shoqerore-dhe-shendetesore	E plotë	Nuk ka

Shënim:

(1) Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

(2) Data e regjistrimit të kërkesës.

(3) Përmbledhje e objektit të kërkesës duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(4) Data e kthimit të përgjigjes.

(5) Përmbajtja e përgjigjes duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

(6) Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

(7) Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik